

KANGA MAJEKRAHIT

Nikolla SPATHARI

PËRMBLEDHJE

Kanga Majekrahit është kënga më autentike e Malësive të Veriut. Ajo zë vendin e një hyni shekullor të malësorëve. Kjo këngë e vjetër deri në sot nuk është studiuar në mënyrë serioze, ndonse është ndër më të herëshmet këngë që vijnë nga thellësia e shekujve. Trashigimia kulturore ilire është një trashigimi e vyer. Ajo i takon popullit tonë dhe vetëm atij, pamvarësisht nga interferencat. Gjithçka që i ka shpëtuar kronikës epokale të humbjes, siç është "Kanga Majekrahit, është një visar për kombin. Këto visare të pakta, jo vetëm që janë trashëguar, por edhe kanë kaluar nepër etapa të reja të zhvillimit historik. Kanga-Majekrahit u ka bërë shumë përshtypje studjuesve dhe udhëtarëve të huaj. Edit Durham e identifikon këngën shqiptare pikërisht me këtë këngë, e quan këngë tipike shqiptare.

Fjalë kyçe - *Kanga Majekrahit, autentike, Malësi e Veriut, hyni shekullore, trashigimia kulturore, ilire.*

HYRJE

Të parët tanë, *ilirët*, duke qenë njëri nga popujt më të lashtë të Europës, domosdo që shumë heret u bënë edhe *faktor* i zhvillimit të kulturës së hershme në kontinent. Malësia e Madhe është si një *muze antik* ku gjinden *eksponate* të shumta të lashtësisë më të hershme, sidomos në universin e *vlerave shpirtërore*. Por sistemi i vlerave të vjetra shpirtërore në Malësi është një sistem *ekocentrik*. Dhe ashtu si të gjitha sistemet ekocentrike edhe ai ka në qendër *yllin e tij më të ndritshëm*. Ky *yll* është *himni shekullor i malësorëve* që mban emërtimin më interesant dhe më origjinal, *Kanga-Majekrahit*. Një *liqjërata muzikore* tepër lakonike, por ndoshta liqjërata më e herëshme që është ruajtur në folklorin muzikor shqiptar. Me siguri, pikërisht këtë këngë, ka pasur parasysh Eqrem Çabej kur shkruante: "Meloditë që do të jenë muzikalisht dhe kronologjikisht më të vjetra, rrojnë në këngët e malësorëve të Shqipërisë Veriore. Kjo këngë solo e fortë është shprehja e qëmoçme e malësorit të lirë, gjurma tingëllore e fundit të shtresës primere të kulturës shqiptare".¹⁾ *Kanga-Majekrahit*, si melodi e vjetër, që u ka rezistuar shekujve dhe ka ardhur gjer në ditët tona, ka pasur fatin e madh sepse në shekuj është bërë *himni* i malësorëve. Shndërrimi i saj dalëngadalë në një *himn* e ka sfiduar në mënyrën më të shkëlqyer *kronikën* epokale të humbjeve të mëdha. Madje, edhe tashti, që prej kohe kanë hyrë në shkallë të gjërë orkestrat dhe këngëtarët e specializuar, dasma fillon me *Kangën-Majekrahit*, pastaj hyn në veprim orkestra dhe këngëtarë që ka ardhur për ta bërë sa më të gëzueshme dasmën.

1. KANGA MAJEKRAHIT

Në kërkim të hapave të parë të historisë së artit zbulimet tregojnë se, ç'prej 50 mijë vjetësh, jeta e njerëzimit ka filluar të pasurohet edhe me krijimtari. Jo vetëm t'i kërkosh, po edhe t'i imagjinosh kaq larg rrënjët e artit është një marramendje e pashembullt. Krijimet e vjetra të

¹⁾ Eqrem Çabej: "Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes", Tiranë, 1994, faqe 46.

mendjes njerëzore sigurisht janë përshkuar nepër një *kronikë humbjesh* të mëdha. Megjithatë është një detyrim kombëtar të kërkosht shtë çfarë mund t'u ketë shpëtuar valëve të zhdukjes së madhe mijërvjeçare.

Në kahun e pesëdhjetëmijëvjeçarit të kaluar çdo popull ecën për hesap të vet. Është me interes të madh qoftë edhe një hap i vetëm i hedhur në këtë drejtim. Nëqoftëse diçka e lashtë i ka shpëtuar *kronikës* tragjike të humbjes shekullore, ajo është një fatbardhësi kombëtare më tepër.

Të parët tanë, *ilirët*, duke qenë njëri nga popujt më të lashtë të Europës, domosdo që shumë heret u bënë edhe *faktor* i zhvillimit të kulturës së hershme në kontinent. Ata janë *përftuesit* e kulturës parahistorike të *Hallshtatit* në Tirol të Austrisë. Një kulturë kjo që daton shumë heret - 35 shekuj më parë. Gjithashtu janë gjyshërit tanë *ilirë* që u përket *Kultura Lusaciane* e kohës së *bronxit* në Poloni, si dhe *kultura* të tjera tepër të njohura. Lexuesi i thjeshtë mund të pyes se ç'hyjnë këtu Austria dhe Polonia? Por edhe ai duhet ta dijë se shtrirjen e dikurshme të *ilireve të moçëm* nuk e përcaktojnë dot kufinj të sotëm të Shqipërisë, madje as ata të Ballkanit. *Ilirët* ishin një popull i madh i Europës antike, ndaj ishin shpërndarë gjer larg në viset e saj. Për këtë *trysni ilire* Franz Altheim në mes tjerash shkruan: "Në mbarim të XIII shekull para Krishtit Iliriasit fituen për të parën herë një randsi historike botnore..."²⁾

Trashigimia kulturore ilire është një trashigimi e vyer. Ajo i takon popullit tonë dhe vetëm atij, pamvarësisht nga interferencat. Gjithçka që i ka shpëtuar *kronikës epokale të humbjes* është një *visar* për kombin. Këto *visare* të pakta, jo vetëm që janë trashëguar, por edhe kanë kaluar nepër *etapa të reja* të zhvillimit historik.

Krijimtaria artistike kolektive e të parëve tanë të lashtë është trokitja më e fuqishme që vjen nga antikiteti. Dhe është një plotësi e habitëshme e të gjitha degëve të artit të moçëm. Por edhe ndërmjet këtyre degëve të artit të dikurshëm sigurisht që ka vite e ndoshta edhe shekuj në mes. Pa hyrë fare në idenë e krahasimit të vjetërsisë së zhanreve të *artit ilir*, do të thosha se *frazat muzikore* mund të jenë gurzit më të hershëm në mozaikun e krijimtarisë tonë të lashtë. Muzikologu Ramadan Sokoli, i cili është njëri nga njohësit më të mirë të trashëgimisë muzikore të popullit tonë, duke e hedhur vështrimin në traditat tona më të lashta muzikore, ndër të tjera thotë: "Nëse stërgjyshërit tanë kishin kulturën, besimin, zakonet dhe gjuhën e tyre, patjetër ata kishin edhe veçantitë e ligjërës muzikore që i dallonin pak a shumë nga popujt e tjerë..."³⁾

Siç kam pohuar edhe diku tjetër, Malësia e Madhe është si një *muze antik* ku gjinden *eksponate* të shumta të lashtësisë më të hershme, sidomos në universin e *vlerave shpirtërore*. Por sistemi i vlerave të vjetra shpirtërore në Malësi është një sistem *ekocentrik*. Dhe ashtu si të gjitha sistemet ekocentrike edhe ai ka në qendër *yllin e tij më të ndritshëm*. Ky *yll* është *himni shekullor i malësorëve* që mban emërtimin më interesant dhe më origjinal, *Kanga-Majekrahit*. Një *ligjërata muzikore* tepër lakonike, por ndoshta ligjërata më e herëshme që është ruajtur në folklorin muzikor shqiptar. Me siguri, pikërisht këtë këngë, ka pasur parasysh Eqrem Çabej kur shkruante: "Meloditë që do të jenë muzikalisht dhe kronologjikisht më të vjetra, rrojnë në këngët

²⁾ Vepër e cituar nga P. Marin Sirdani, "Hylli i Dritës", Nr.4-5, faqe 101.

³⁾ Ramadan Sokoli: "Për traditat tona muzikore", Nëndori, nr.9 - 1965, faqe 117.

e malësorëve të Shqipërisë Veriore. Kjo këngë solo e fortë është shprehja e qëmoçme e malësorit të lirë, gjurma tingëllore e fundit të shtresës primere të kulturës shqiptare".⁴⁾

Mendja të thotë se, pas asaj që Çabej e quan *gjurma tingëllore e fundit e shtresës primere të kulturës shqiptare*, muzikologët duhet të suleshin kush e kush më parë për të vënë në dukje moshën dhe vlerat e saj si *qemeri* më i lashtë i *godinës muzikore shqiptare*. Por fatkeqësisht nuk ka ndodhur kështu. Me sa di unë asnjë shqyrtim serioz i saj deri më sot nuk është bërë. Për çudi edhe muzikologët veriorë, përfshi këtu edhe profesorin e nderuar Ramadan Sokoli, më tepër kanë rendur pas studimit të *polifonisë* duke lënë disi në harresë këtë thesar të lashtësisë muzikore shqiptare. Vërtetë *kënga me polifonike* është *E Bukura e Dheut* e folklorit muzikor shqiptar të lindur në fillimet e jetës kolektive të të parëve tanë. Por shkëlqimi i saj nuk zbehet aspak nëqoftëse themi se kemi një traditë edhe më të lashtë muzikore të zhvilluar në jetën më të vetmuar të malësorëve. Unë e konsideroj *nder kombëtar* po qe se ne kemi, jo një, po dy ose më shumë *bukuroshe* të artit të lashtë muzikor.

Nuk them se *Kanga-Majekrahit* nuk është përmendur nga studjuesit tanë. Por t'i kalosh tangent nuk do të thotë ta studjosh. Të përmendësh vetëm kalimthi *një thesar* kaq të vjetër të kulturës së moçme shqiptare nuk mund të prehesh i qetë se e ke kryer detyrën tënde ndaj *vlerave antike* të kulturës shekullore kombëtare.

Kanga-Majekrahit, si melodia më e vjetër që u ka rezistuar shekujve dhe ka ardhur gjer në ditët tona, ka pasur fatin e madh sepse në shekuj është bërë *himni* i vetëm i malësorëve. Shndërrimi i saj dalëngadalë në një *himn* e ka sfiduar në mënyrën më të shkëlqyer *kronikën* epokale të humbjeve të mëdha.

Himnet kombëtare të popujve janë gjithmonë disi të vonë. Ata vijnë pas një historie të tërë, si një koncentrat i saj. Edhe kombi ynë, si të gjitha kombet e tjera, ka *Himnin Kombëtar* të tij. Por u deshën epoka të tëra luftrash dhe përpjekjesh gjersa ato të reflektoheshin në mënyrë lakonike në një *himn*. Kjo ndodhi vonë, shumë vonë, vetëm në shekullin njëzet. Megjithatë kjo nuk do të thotë se para konsolidimit të kombit nuk kanë ekzistuar *himne* të tjera të vjetra. Siç duket populli ynë i lashtë ka pasur një përvojë të gjatë *himnesh* derisa ka arritur tek *Himni Kombëtar*. Sigurisht, si shumë gjëra të tjera, këto *himne* kanë humbur. Por, në dallim me popujt e tjerë, shqiptarëve u ka shpëtuar njëri nga *himnet* më të moçme, falë *karakterit konservativ* të malësorëve.

Kanga-Majekrahit edhe sot e kësaj dite ruan të gjitha atributet e një *himni*. Prandaj është me vend që atë ta konsiderojmë si *Himni Shekullor i Malësorëve*. Ajo është kënga që hap çdo log, çdo festë, çdo dasëm, çdo grumbullim. Madje, edhe tashti, që prej kohe kanë hyrë në shkallë të gjërë orkestrat dhe këngëtarët e specializuar, dasma fillon me *Kangën-Majekrahit*, pastaj hyn në veprim orkestra dhe këngëtarit që ka ardhur për ta bërë sa më të gëzueshme dasmën. Mjafton ky *atribut kryesor i himneve* për të thënë se *Kanga-Majekrahit* është një *himn* si të gjitha *himnet*.

Kanga-Majekrahit u ka bërë shumë përshtypje studjuesve dhe udhëtarëve të huaj. Edit Durham e identifikon këngën shqiptare pikërisht me këtë këngë, e quan *këngë tipike shqiptare*. Për festën e Shën Nikollës që bie më 9 maj ajo ka vajtur nga Bratoshi në Shkrel, për të marrë pjesë në

⁴⁾ Eqrem Çabej: "Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes", Tiranë, 1994, faqe 46.

kremtimet që bënte *Mali* i Shkrelit me këtë rast. Ka të ngjarë që në këtë festë madhështore gjëja që i ka lënë më shumë mbresa studjueses angleze është kënga e çuditëshme *Majekrahit*, ndaj shkruan: “*Pas darkës kënduam këngë tipike shqiptare që janë të pashoqe. Shkalla (muzikore-N.S.) shqiptare nuk është si shkalla moderne evropiane, por është e tëra me gjysmëtone dhe me tone të thyera. As muzika nuk ka kohë të rregullt. Ritmi i saj është i shpejtë ose i ngadalshëm, sipas ndjenjës dramatike të këngëtarit, dhe fjalët janë të zgjatura në mënyrë të pabesueshme e me kthesa minore të gjata, me ngritje dhe ulje zëri që pak gurmaze anglezësh do të mund t’i imitonin*”.⁵⁾

Siç shihet edhe nga ky pasazh Edit Durham *Kangën-Majekrahit* të malësorëve e konsideron, jo vetëm një këngë *tipike shqiptare*, por edhe një *këngë të pashoqe*. Ajo vërtetë nuk e përmend emrin e këngës, por kushdo që e njeh sadopak *Kangën-Majekrahit* e kupton menjëherë se përsëkrimi i mësipërm i përket asaj dhe vetëm asaj.

Kanga-Majekrahit është një *thesar* i artit primitiv të stërgjyshërve tanë të lashtë. Ajo është pjellë e kohërave shumë të vjetra dhe pasqyron karakterin historik të shprehur në një ligjëratë tepër të thjeshtë, por tepër të thekëshme muzikore. Ky *himn* është modelimi më i moçëm artistik i kohrave të lashta historike që kaluan dikur në këto *Male*.

Arti në përgjithësi është *imitim*. Një *imitim* i jetës reale të shoqërisë. Për rëndësinë e imitimit në origjinën dhe zhvillimin e artit flasin shumë filozofë, studjues e kritikë. Njëri nga ata, rusi Georg Plehanov shkruan: “*S’ka asnjë dyshim se imitimi ka luajtur një rol shumë të madh në historinë e të gjithë ideve tona, shijeve, modës dhe zakoneve tona...*”.⁶⁾

Është logjike të thuash se sa më i thjeshtë, sa më direkt të jetë *imitimi* i copëzave të jetës historiko-shoqërore në një krijim artistik, aq më i lashtë ka mundësi të jetë *krijimi*. *Kanga-Majekrahit* është *imitim direkt* i karakteristikës më dalluese të jetës luftarake të malësorëve që është *kushtrimi*. Asnjë detaj luftrash nuk ishte sa kushtrimi *lendë* aq e gatshme, që me një *imitim* të thjeshtë, të ngjitej në sferat e një *krijimi artistik primitiv*. Ndoshta, askush si malësorët nuk ka arritur që dy *koncentratet* më të fuqishme të luftrave të lashta shqiptare, *kushtrimin mbi male* dhe *dyluftimin* me armë të bardha t’i kthejë në *krijime artistike* jetëgjata. *Kushtrimi*, si prologu i çdo lufte, e ngacmoi që heret *genin artistik* të malësorit. Ai duhej të bëhej *himn*, ashtu siç duhej të bëhej *vepër koreografike* dyluftimi trup me trup si pika më kulminante e çdo beteje. Me *Kangën-Majekrahit* dhe *Vallen e Shpatave* imitimi krijues kapte dy anët më artistike të çdo lufte. Aftësia për të selektonuar ato që ishin prozaike në luftrat e përgjakshme dhe për të bërë vepra artistike koncentratet më poetike të betejave është aftësi prej artisti të lindur. Malësori i moçëm nuk është, pra, vetëm një *luftëtar* i shkëlqyeshëm, por edhe një *artist* i lindur i cili, mu në mes të prozaizmit, din të zgjedhë poetikën e jetës së vrazhdë historiko-shoqërore.

Mekanizmi krijues i *Kangës-Majekrahit* është *imitimi artistik* i kushtrimeve të dhëna në shekuj. Këtë mekanizëm, ai që e ka kuptuar më saktë, e ndoshta edhe më heret, më duket se është Eqrem Çabej kur thotë: “*Po t’i shikojmë për nga gjeneza, këto melodi nuk janë tjetër veçse thirrma e britur dhe e dëgjueshme që larg, të cilën e ndeshim në gjithë popujt malësorë. Por në rasën tonë mund të kemi të bëjmë me thirrjen e kasnecit e cila në kanunin tradicional të këtyre viseve luan*

⁵⁾ Edit Durham: “*Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera...*”, Tiranë 1990, faqe 128-129.

⁶⁾ Plehanov, Vorovski, Lunaçarski, Gorki: “*Estetika dhe letërsia*”, I, Tiranë 1974, faqe 51.

një rol të rëndësishëm në pikëpamje sociale-ushtarake. Kjo do të jetë ndofta origjina e këtyre melodive".⁷⁾

Modest në gjenialitetin e tij, Çabej, për të mos qenë i prerë në receta, përdor fjalën *ndofta* edhe pse duket plotësisht i sigurtë se kemi të bëjmë pikërisht me *thirrjen e kasnecit*, domethënë me *kushtrimdhënien* mbi male.

Arti është produkt i kohës. Ai nuk ka si të kuptohet jashtë kohës kur ka lindur dhe jashtë rrethanava historike që e kanë lindur. Vepra artistike, si koncentrat estetik përvoje njerëzore, frymëzohet nga idetë dhe proceset historike të epokës. Por kur ajo reflekton kënaqësi estetike dhe në brezat njerëzor të epokave pasardhëse do të thotë se parametrat artistikë të epokës së vet i ka pasur të plotë. *Kanga-Majekrahit* ka përshkuar epokat pa e humbur vlerën e saj artistike në Malësi. Kjo gjë e rreshton atë në veprat artistike primitive me vlerë që i vijnë nga lashtësia e thellë popullit shqiptar. Mbase ajo i përket asaj kategorie krijimesh për të cilat Prof. Alfred Uçi shprehet: *"...Veprat e shquara artistike të krijuara në një epokë e ruajnë vlerën dhe pëlqehen edhe nga njerëzit e një epoke tjetër".⁸⁾*

Kanga-Majekrahit sëbashku me *Vallen e Shpatave* japin pasqyrimin artistik përgjithsues të të gjitha lufrave të lashta që fillonin me një kushtrim mbi male dhe përfundonin me ndeshjet dyluftuese me jatagana. Asnjë personalitet krijues, sado i fuqishëm të ketë qenë, nuk ka mundur të bëjë një përgjithësim artistik të betejave të lashta në mënyrë kaq lakonike, me një ligjëratë muzikore prej tre vargjesh dhe një valle të ashpër armësh të bardha. Çuditërisht malësori i lashtë është një krijues *fin*, armik i proliksitetit që prish e shkatërron çdo krijim artistik.

Në gjithë universin e këngës folklorike shqiptare nuk ekziston një këngë tjetër që të jetë një *imitim artistik* i përpiktë i një veprimi karakteristik të lufrave të moçme të të parëve tanë. Qoftë edhe ky fakt i vetëm të lejon të nxjerrësh përfundimin se *Kanga-Majekrahit* është ligjërata muzikore më e vjetër e fondit folklorik shqiptar që na ka mbetur, pamvarësisht se studjuesit tanë nuk kanë pasur guximin apo dashamirësinë për ta pohuar me gojën plot e në mënyrë të prerë këtë gjë.

Duke ndjekur gjurmët më të lashta të muzikës tek stërgjyshërit tanë të moçëm, Profesor Ramadan Sokoli ndalet me një lloj keqardhjeje dhe shkruan: *"Ndoshta gërmimet dhe hulumtimet e ardhëshme kanë për të nxjerrë në dritë edhe pjesë muzikore të shkrueme me ndonjë alfabet ose sistem semiografik të vjetër. Dëshifrimi i këtij shkrimi ka për të na sjellë ushtimën e muzikës së stërgjyshërve tanë".⁹⁾* Pa dyshim që gërmimet dhe hulumtimet mbase do të sqarojnë shumë gjëra për paraardhësit tanë të moçëm edhe në fushën e muzikës. Por unë do të thosha se në pritje të gërmimeve dhe hulumtimeve është e arsyeshme që muzikologu të merret me ato *fraza* të lashta muzikore që duke gjalluar në popull i ka mu përpara syve. Sepse *ligjërata* të tilla muzikore, siç është *Kanga-Majekrahit*, e sjellin tek ne jehonën e *muzikës stërgjyshore* edhe para se gërmimet ta nxjerrin nga nëntoka. Të anashkalosh pjesë shumë të vjetra muzikore që ruhen në popull për të pritur të tjera që mund të dalin nga nëntoka arkeologjike është njëlloj si të anashkalosh ujkun në kërkim të gjurmëve të tij.

⁷⁾ Eqrem Çabej: *"Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes"*, Tiranë 1994, faqe 47.

⁸⁾ Alfred Uçi: *"Estetika"*, Tiranë 1989, faqe 4.

⁹⁾ Ramadan Sokoli: *"Për traditat tona muzikore"*, Nëndori, Nr.9 - 1965, faqe 118.

E çmoj shumë Profesor Sokolin. Por do të marr leje para autoritetit të tij prej muzikologu për të thënë mendimin tim në këtë pikë. Dhe mendimi im është se t'u biesh pas gjurmëve të lashta muzikore të stërgjyshërve tanë të vjetër nuk mund të fillosh as nga këngët *me iso* as nga Niketa i Remezianës, por pikërisht nga *Kanga-Majekrahit*. Sot për sot andej dhe vetëm andej duhet të nisesh. Nëqoftëse gërmimet arkeologjike do të nxjerrin një *ligjëratë muzikore* më të moçme, atëhere kjo pikë referimi mund të ndryshojë. Por derisa të kemi një *ligjëratë* tjetër muzikore më të vjetër *Kanga-Majekrahit* duhet të vihet si qendër e kordinatave për të përcaktuar atë pjesë të grafikut tonë të lashtë muzikor që mund të përcaktohet. Ajo u shfaq shumë heret. Ndoshta në ato kohra kur horizonti muzikor i të parëve tanë ishte fare i zbrastë. Dhe jetoi gjatë, shumë gjatë, më gjatë se çdo këngë tjetër, duke ruajtur gjithmonë paramaterat e lashtë të *imitimit krijues* të kushtrimeve. Unë nuk njoh një këngë tjetër në gjuhën shqipe që të ketë ushtruar një ndikim kaq të fuqishëm estetik mbi ndërgjegjen e brezave, sa të mbajë sferat e larta të *himnit* për shekuj të tërë, që nga lashtësia e thellë e deri në kohët tona moderne.

Kushtrimi mbi male ka qenë *briri* më i lashtë i luftës për të parët tanë të hershëm. *Briri i luftës*, i volitshëm për hapësira të kufizuara kështjellash, nuk mund të shërbente si sinjal për relieve të gjëra që nxirrnin ushtritë vullnetare të *Maleve* vetëm atëhere kur rrezikoheshin trojet. Ndërsa *kushtrimet* përcilleshin nga mali në mal duke përhapur sinjalin e luftës në tërë Malësinë në një kohë tepër të shkurtë. Atmosfera e *kushtrimeve* ndjehet kudo në Malësi, duke filluar nga toponimia: *Shkambi i Kushtrimit*, *Rrethi i Kumtës*, etj. *Kushtrimi* dhe *kumti*, në të folmën e malësorëve, janë sinonime që shprehin të njëjtën gjë. Njerëzit në Malësi kanë shumë dëshirë të tregojnë histori. Kjo dëshirë mbase u ka mbetur nga kohë shumë të lashta, ngaqë historia e tyre nuk shkruhej gjëkund, po tregohesh brez pas brezi. Dhe është për t'u shënuar se të gjitha historitë që tregojnë malësorët fillojnë pak a shumë në të njëjtën mënyrë: "*U dha kushtrimi se mësyni turku*", "*U thirr kushtrimi se ra shkjav*" apo "*Plasi kushtrimi se sulmoi serb*". Domosdo një detaj i tillë i paharruar i çdo lufte ishte njëra nga *lëndët* më të gatshme artistike për t'u kthyer në këngë.

Është e pamundur të përcaktohet se cili nga *kushtrimet* e moçme u kthye i pari në *këngë* të mirëfilltë. Patjetër ky është një proces që ka zgjatuar në shekuj. Në fillim *imitimi* i kushtrimeve ka qenë një *imitim* i thjeshtë me rrokje të zgjatura siç janë të gjitha *kushtrimet*. Me kalimin e kohës ky imitim i thjeshtë është bërë përherë e më *artistik*, duke marrë nuanca të reja *muzikore*, dhe duke u kthyer më në fund në një *këngë-himn*. Por nëqoftëse nuk mund të dihet *kushtrimi* më i vjetër që u këthye në *Kangë-Majekrahit*, dihet plotësisht *kushtrimi* më i ri që ka pësuar metamorfozën artistike të shëndrrimit në *këngë*. Siç do ta shohim më poshtë ky *kushtrim*, i fundit që është bërë *këngë*, është dhënë rreth 130 vjet më parë. Edhe kaq nuk është një hershmëri e vogël, sidomos kur ke parasysh se ky është caku i fundit i *procesit historik* të kthimit të kushtrimeve në këngë.

Variantet më të moçme të berjes këngë të kushtrimeve i ka përfshirë në gjirin e vet *kronika* tragjike e humbjeve shekullore. Megjithatë edhe ato që kanë mbetur janë *ligjëratë muzikore* që flasin për luftëra mjaft të hershme, pa çka se shumë *ligjëratë* të tilla mijëvjeçarët i kanë hedhur prapa shpatullave të harrimit. Por le të kënaqemi me atë çka ka mbetur. Në Malësi të Madhe janë tre variante të *Kangës-Majekrahit* që kanë mundur t'u rrezistojnë shekujve, ose me saktë tre tekste të vjetra se melodia është po ajo. Në sfera *himni* ato kanë qenë të *fortifikuara* para çdo

kataklizme duke u kënduar me po atë pathos edhe sot e kësaj dite, krahas muzikës së re që ka hyrë gjithandej në Malësi. Të tre variantet, siç e thamë, ndryshojnë vetëm nga fjalët, domethënë ndryshon vetëm evenimenti i kushtrimit, ndërsa vija melodike është po ajo. Duke i shqyrtuar me kujdes të tre variantet e mbetura, ato vetë të ndihmojnë për të përcaktuar moshën e tyre. Por fatkeqësisht studjuesit dhe muzikologët tanë as që janë marrë me këtë gjë. Ata kanë qenë të interesuar se ç'ka thënë ky apo ai studjues i huaj për lashtësinë e muzikës sonë pa u lodhur shumë që ta deshifrojnë këtë lashtësi në vetë brendinë e këngëve më të moçme siç është *Kanga -Majekrahit*. Në koleksionin e këtyre tri *ligjëratave* më të vjetra muzikore dallohen qartë luftrat që i kanë lindur. Ajo më e lashta ka lidhje me betejën e Fushë Kosovës të vitit 1389. Kënga nuk është asgjë tjetër veçse kushtrimi i dhënë në Malësi në ato ditë të largëta e të lavdishme të shekullit të katërbëdhjetë:

"Fjalë po bjen era/Luftë, o, po bajnë/ Rugova e Peja".¹⁰⁾

Këtu *era* është njëkohësisht mjet *real* dhe mjet *artistik*. Si mjet *real* ajo flet për kohë tepër të largëta. Flet për atë praktikë shekullore kur *telegrafi* stërgjyshërve tanë ishte *era*. Ajo dhe vetëm ajo përcillte mbi male kushtrime, kumte, mandata e lajme të gëzuara fitoresh.

Beteja e Fushë Kosovës, ku ushtritë e besëlidhura të një pjese të *Europës Juglindore* treguan një heroizëm të madh përballë mizërisë ushtarake të Sulltan Muratit, nga një shesh i madh lufte u këthye menjëherë në një burim madhështor këngësh. Selami Pulaha, duke shkruar për vazhdimësinë e popullit shqiptar në trojet e veta autoktone të Kosovës, mes tjerash thotë: "*Në të mirë të kësaj flet edhe ekzistenca e vazhdimësia të shqiptarët e Kosovës e këngëve që sjellin jehonën e ngjarjeve luftarake të betejës së vitit 1389*".¹¹⁾

Nuk mund të gjendet një *betejë* tjetër në historinë e *Europës Juglindore*¹²⁾ që të ketë gjeneruar aq shumë këngë, sa ç'është "*Beteja e Fushë Kosovës*. Në vitin 1953 është ngritur atje *Përmendorja e trimave të Kosovës*. Kjo *përmendore* është një kullë e lartë prej 25 metrash, e ndërtuar me gurë shumë ngjyrash sipas stilit të kullës mesjetare. Nuk është objekti im të përshkruaj këtë vepër arti të akademikut A. Deroku, por dua të them se aq shumë këngë popullore këndohen për këtë betejë sa autori nuk i ka shpëtuar tundimit që brendësinë e përmendores ta stolisë me vargje këngësh popullore. Vargjet e zgjedhura janë shkruar me germa bronxi në pllaka prej guri. Këngës që cituam më sipër, dhe që ka mbi 600 vjet që këndohet në Malësi, mbase do t'i takonte të parës të zinte vend në muret e përmendores që zotëron mbi rrafshnaltë. Por nuk mund të pretendohet që në vargjet e zgjedhura nga M. Paniq të bënte pjesë kënga më karakteristike shqiptare që në shekuj është këthyer në një *himn* shekullor kushtuar *Betejës së Fushë Kosovës*. Vërtetë kjo është kënga më e vjetër dhe më *imitative* e çastit heroik të *betejës së famëshme*, por politika mbetet politikë. Me bisturinë e saj djallëzore ajo operon mbi historinë dhe kulturën e popujve, në përshtatje me dëshirat dhe interesat nacional-shoviniste të atyre që pushtojnë fronet. Në ethet e serbomëdhenjve për ta uzurpuar plotësisht *Betejën e Fushës së Kosovës* ishte fare e lehtë që të spostohej kënga më e vjetër e më origjinale shqiptare që i kushtohej asaj. Ata bënë gjëra edhe

¹⁰⁾ Një variant i "*Kangës-Majekrahu*" që këndohet në Malësi të Madhe.

¹¹⁾ Selami Pulaha: "*Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shekujve XV-XVI*", Tiranë 1984, faqe 17.

¹²⁾ Përdori këtu emërimitin "*Europa Juglindore*", sepse sipas F.Konicës fjala turke "*Ballkan*" është përdorur për herë të parë në vitin 1808.

më të rënda e më monstruoze. Fallsifikuan *etninë* e heroit kryesor *Milosh Kopili* duke i shtuar atë *iq-in* e tyre të *famshëm*. Por diellit nuk mund t'i bëjë eklips një shoshë serbe, sado e sofistikuar që të jetë. Heroi që vrau Sulltan Muratin dhe hyri madhërisht në historinë e lashtë të *Europës Juglindore* i përket *etnisë shqiptare*. Kjo padyshim është e hidhur për *shkencëtarët plebejë të shovinizmit*, të cilët përpiqen t'i mohojnë popullit shqiptar të Kosovës autoktoninë në trojet e veta dardane, duke bërë politikë safi në vend të shkencës.

Mirë se heroin kryesor të betej duan ta përvetësojnë, po ç'u prishte punë një këngë, mes këngëve të tjera, në hapësirat e brendshme të përmendores? Nganjëherë ca vargje të vetme dëshmojnë më shumë se volume të tëra të shkruara. Kënga *Fjalë po bjen era* tregon në mënyrë autentike se për *Betejën e Fushës së Kosovës* i është dhënë kushtrimi Shqipërisë për t'u gjetur atje. Pikërisht ky fakt nuk u duhet serbomëdhenjve që duan ta paraqesin *betejën e famëshme* vetëm si një betejë mes Serbisë dhe Perandorisë Osmane.

Fatkeqësisht mungojnë dokumentet e shkruar që mund të vërtetonin se kanga-majekrahu *Fjalë po bjen era* vjen nga një largësi mbi 600 vjeçare vitesh. Të gjëndur para kësaj mungese e vetmja rrugë është mbështetja në kujtesën e pavdekshme të popullit, sepse siç thotë Plutarku kur shkruan për Demostenin: "...ato gjëra që u kanë shpëtuar shkrimtarëve, por janë ruajtur në kujtesën e njerëzve, kanë fituar një besueshmëri më të madhe...". Pra ato që dinin korifejt e *Kangës-Majekrahit* sigurisht që kanë një vlerë të madhe studimore, pasi ata sëbashku me këngët kanë mësuar nga të parët, pothuajse gjithmonë, edhe origjinën e tyre.

Pjetër Dulja i Kastratit konsiderohet në Malësi si patriarku i këngës. Ai ka rreth shtatëdhjetë vjet që ka vdekur, por duke vlerësuar ato që thonë të moshuarit, është i vetmi që ka bërë epokë në këngën malësore, ashtu siç ka bërë epokë Bik Ndoja në këngën qytetare shkodrane. Këngëtari i shquar i ditëve tona, Bik Ndoja, është mbiquajtur "*Bilbili i Këngës Shkodrane*". Për analogji ndoshta edhe Pjetër Dulja mund të quhej "*Bilbili i Këngës Malësore*". Fatkeqësisht në kohën kur ka jetuar ky sovran i *Kangës-Majekrahit* dhe i këngës me *lahutë* nuk kishte mjete elektronike. Është ruajtur ç'mund të ruhej në "*shiritin*" e pavdekshëm të kujtesës së popullit, por kjo është fare pak. Në vend të këngës ka mbetur vetëm lavdia e saj.

Në Malësi të Madhe sa here përmendet *Kanga-Majekrahit* përmendet mekanikisht edhe ky këngëtar, sepse ka më shumë se një shekull që është identifikuar me këtë këngë. Shkruante më gjatë për këtë këngëtar që tashmë është kthyer në legjendë të këngës. Aq më tepër që ai nuk ishte vetëm një këngëtar i dëgjuar, por edhe një burrë kuvendi, një ligjvënës kanunor dhe një luftëtar në ballë të Ushtrisë së Maleve.

Siç thamë ka dekada që ky këngëtar është ndarë nga kjo botë. Por fatmirësisht ai nuk i ka marrë më vete në varr të gjitha ato që dinte për këngët që këndonte. Afro dyzet vjet të shkuara unë e pyrta të shoqen, Drande Preçen, nëse dinte gjë ai se qysh kur janë kënduar këngë të tilla si bie fjala kënga *Fjalë po bjen era*. Dhe ajo m'u përgjegy: "*Ai thoshte se kjo kangë ka dalë kur asht vra Sulltani në dhë të përpjetës*".¹³⁾ Me fjalët *në dhë të përpjetës* ajo nënkuptonte viset e Kosovës.

¹³⁾ Nga biseda me Drande Preçen, gruan e kryekëngëtarit të Malësisë, zhvilluar më 6 dhjetor 1960.

Përfundimisht, duke u mbështetur si në vetë brendinë e këngës si dhe në ato që këngëtarët e shquar të Malësisë, siç ishte Pjetër Dulja, i Kastratit, i kanë transmetuar, nga brezi në brez, njëri-tjetrit për evenimentin historik që zakonisht e lind një *Kangë-Majekrahi*, mund të them, pa pasur dyshim se gaboj, që *Kanga-Majekrahu* që emërtohet *Fjalë po bjen era* është kushtrimi i dhënë mbi male, ndërsa në Kosovë vringëllonin shpatat më 1389.

Çdo *Kangë-Majekrahi* ka lidhje direkt me një eveniment të madh historik. Është si të thuash *himni* luftarak i një faqeje të historisë kombëtare. Nga thellësi të mëdha shekujsh ka ardhur edhe kënga tjetër *Burrë-o, je, i vogël*. Janë të gjitha gjasat që kjo këngë shumë e vjetër u përket viteve 1421-1423. Vargjet e saj të kursyera janë: “*Burrë-o, je, i vogël, / Po i hip atit-o, / Bjer-o në Shkodër*”.¹⁴⁾

Nga vetë përmbajtja e saj duket qartë se kënga është një kushtrim i dhënë në Malësi për të ndihmuar Shkodrën e rrethuar nga një armik tepër i egër. Dhe sipas mendimit tim tri janë rrethimet e mundëshme që mund të kenë inspiruar këtë këngë *imitative*: Rrethimi që i bëri qytetit të lashtë princi serb Stefan Lazareviç nga viti 1421 deri në vitin 1423. Rrethimi turk i Shkodrës i vitit 1478. Dhe së fundi rrethimi serbo-malazez i fillimit të shekullit njëzet. Këto dhe vetëm këto janë tre rrethimet e famëshme të kryeqendrës veriore që mund të jenë bërë shkak për një kushtrim të tillë, i cili përshkoi shekujt në formën e një kënge.

Duke përdorur metodën matematike të përjashtimit, mund të themi, me vërtetësi të plotë, se kënga në fjalë nuk ka të bëjë fare me rrethimin e fundit të qytetit të Shkodrës (1912-1913). Ajo këndohej në Malësi shumë e shumë vite para se të ndodhte ky rrethim. Këngëtari i dëgjuar Dodë Prendashi i Kastratit, kur e pata pyetur në se kënga *Burrë-o, je, i vogël* është kënduar para se të ngrihej flamuri në Vlorë apo jo, më pati thënë me habi: “*Flamuri asht ngritë vonë, ajo kangë asht denbabaden*”.¹⁵⁾ Ndërsa Nikollë Deda i Shkrelit fliste për një fakt tjetër interesant. Ai kujtonte se ditën e Shënkollit Maj, në *logun* që bëhej te Kroni i Dedajve, këndoi edhe Marash Dulja. Ndonëse ishte i vogël e bëri të shungullojë Malin e Kurriës kur ia mori këngës *Burrë-o, je, i vogël*. Gjelojsh Gjoka i Kastratit, që ishte miku më me personalitet i *logut*, u entuziazmua që një kastratas i vogël e tundi *logun* në Shkrel, nxorri alltinë nga brezi dhe e shkrepiti tre herë duke i thënë: “*Të lumtë goja! Ti kenke me të vërtetë një burrë i vogël*”.¹⁶⁾ Sipas Nikollë Dedës kjo ngjarje kishte ndodhur një vit më parë se të pëlciste pushka kundër nizamëve turq, të rrethuar nga malësorët e Dedë Gjo’ Lulit në dy kaushat e Grykës së Leqeve. Domethënë në festën e Shënkollit Maj të vitit 1910. Pra kënga nuk i përket rrethimit të fundit të Shkodrës. Ajo është më e lashtë. Por sa më e lashtë?

Në kërkim të moshës së saj tashmë duhet të kapërcejmë shekujt dhe ta hedhim vështrimin në rrethimin famëmadh të Shkodrës të vitit 1478. Në pamje të parë e vërteta për origjinën e këngës *Burrë-o, je i vogël* duket sikur është e lidhur pikërisht me këtë rrethim. Por Marin Barleti në veprën e tij “*Rrethimi i Shkodrës*” ka një pasazh që mua më duket se indirekt e hedh poshtë mendimin se kjo këngë mund të jetë kushtrimi i dhënë në Malësi me rastin e këtij rrethimi. Sipas tij malësorët nuk janë sulur nepër tokë, në shpinë të atllarëve, siç thotë kënga, për t’i ardhur në

¹⁴⁾ Njëri nga variantet e “*Kangës-Majekrahu*”.

¹⁵⁾ Nga biseda me Dodë Prendashin, zhvilluar më 30 mars 1957.

¹⁶⁾ Nga biseda me Nikollë Dedën e Shkrelit, zhvilluar më 24 prill 1961.

ndihmë Shkodrës, por kanë vozitur me lundra nepër liqe. Në mes tjerash, Barleti shkruan: “Ditë për ditë nga liqeni, që është përbëri Shkodrës e për të cilin folëm, vinin me lundra e barka në shumicë shqiptarët që banonin rreth e përfaqë atij liqeni e, duke kaluar nepër Bunë, suleshin si rrufeja mbi shatorret e barbarëve dhe bënin kërde duke u shkaktuar dëme të mëdha”.¹⁷⁾ Por brendia e këngës që kemi në shqyrtim nuk e pasqyron ardhjen në ndihmë të malësorëve në këtë mënyrë. Përkundrazi ajo shprehet qartë se malësorët janë sulur nën kushtrim nepër tokë drejt Shkodrës. Madje, për t’u gjetur sa më parë atje, kushtrimi këshillon që t’u hipin atllarëve. Kjo gjë të bën të mendosh se është një rrethim tjetër i qytetit në të cilin malësorët erdhën në ndihmë, jo nepërmjet liqenit, po nepërmjet tokës. Dhe ky rrethim mund të jetë vetëm rrethimi që Gjergj Brankoviçi i bëri Shkodrës si komandant i trupave të Stefan Lazareviçit. Përshkrimi që i bën Barleti ardhjes në ndihmë të malësorëve në rrethimin që zgjati 2 vjet, për mendimin tim, e verteton se kushtrimi i lashtë i pasqyruar në këngën *Burrë-o, je i vogël* është pikërisht kushtrimi që është dhënë mbi male për të shpëtuar Shkodrën nga ai rrethim i egër. Ja ç’thotë Barleti për rrethimin e trupave të Lazareviçit: “Ai e mbajti qytetin tonë të rrethuar për dy vjet rresht dhe Shkodra, e ngushtuar shumë nga zia, për pak do të ishte dorëzuar, sikur të mos kishte ardhur një ushtri e madhe nga fiset kufitare dhe sikur të mos ishte zmadhuar edhe më kjo ushtri me fiset e të gjithë krahinës”.¹⁸⁾ Nuk ka asnjë pikë dyshimi që ushtri të mëdha në atë kohë mund të mbledheshin vetëm nën një kushtrim të fuqishëm. Është pikërisht ai *kushtrim i paharruar*, i dhënë në harkun kohor 1421-1423, që është bërë këngë dhe këndohet në Malësi ç’prej afro gjashtë shekujsh. Nëqoftëse mendimi im në këtë pikë është pak kategorik, kjo do të thotë se nuk kam mundur të gjej asnjë fakt, sado të turbullt, që e vë në dyshim se origjina e këngës *Burrë-o, je i vogël* të çon në rrethimin e Shkodrës të fillimit të shekullit të pesëmbëdhjetë.

Së fundi erdhëm tek varianti i tretë i *Kangës-Majekrahit* që është ruajtur në Malësi të Madhe. Para se të bëjmë përsiatjet për të përcaktuar momentin historik që e frymëzoi, le të shohim se ç’thotë kënga:

“Fjalë-o për tel/Thotë-o Gjakova Ço-jo-v e del”¹⁹⁾

Tani fjalët nuk i bjen më era si në variantin e parë kur bëhej lufta në *Fushë të Kosovës*. Tashti ato vijnë nepër tel. Dhe pikërisht ky urdhër i ardhur në mënyrë më komode, nepër tel, bëhet *kushtrim* e përhapet mbi male për t’u shëndrruar, në fund të fundit, në *këngë* si të gjitha *kushtrimet* më të rëndësishme historike. Tashmë është koha kur ka filluar të përdoret telegrafi dhe kjo kohë nuk është aq e herëshme.

Të gjitha variantet e “Kangës-Majekrahu” janë prej tri vargësh. Dy vargjet e fundit përsëriten dy herë. Por është për t’u shënuar se këngës *Fjalë-o për tel* kam dëgjuar shumë këngëtarë t’i shtojnë edhe një varg të katërt dhe të këndohet kështu: “*Fjalë-o për tel, Thotë-o Gjakova/Ço-jo-v e del, Se ka ra pasha në sherr*”.

Për herë të parë e kam dëgjuar të këndohet kështu, ky variant i *Kangës-Majekrahit*, nga këngëtari i përmendur Palokë Luketi. Ishte festa e *Ndjesës* së Katundit të Kastratit dhe bëhej *logu* tek Kroni

¹⁷⁾ Marin Barleti: “Rrethimi i Shkodrës”, Tiranë 1982, faqe 55.

¹⁸⁾ Po aty, faqe 119.

¹⁹⁾ Varianti më i ri i “Kangës-Majekrahu”.

i Ri. Në mos u gabofsha ka qenë gushti i vitit 1956. Është vendi të them se Palokë Luketi ka qenë këngëtar i më potent dhe më i dëgjuar i kohës së tij. Në *logjet* e Malësisë së Madhe ai dallohej midis gjithë këngëtarëve të tjerë. Palokë Luketi është konsideruar në Malësi si *Pjetër Dulja* i gjysmës së dytë të shekullit njëzet. Megjithatë kur kishte arritur apogjeun e lavdisë si këngëtar, detyrohet të ndahet nga Malësia që ishte djepi i këngës së tij, sepse regjimi e futi në listat e zeza të internimit, pasi babait të pushkatuar iu shtua edhe arratisja e vëllait, Lleshit. Tashti Llesh Grishaj është një shqiptar i njohur për veprimtari atdhetare në Detroit të Amerikës, por ajo që dua të them është se të gjithë vëllezërit e kanë kënduar *Kangën-Majekrahit*. Palokë Luketi ka shkëlqyer mbi të gjithë këngëtarët e Malësisë së Madhe të kohës së vet, por mjaft bukur e kanë kënduar këtë *këngë* edhe vëllezërit e tij Deda, Lleshi, Gjergji dhe Pjetri. Ata ishin një shtëpi e tërë këngëtarësh. Ndoshta rasti më unik në Malësi.

Siç thamë më sipër *Kanga-Majekrahit* është kënga më lakonike. Tre vargjet e saj janë *normë*. Pikërisht për këtë duket se është suprimuar vargu i katërt "*se ka ra pasha në sherr*". Por kushtrimi nga i cili ka rrjedhur kënga duhet ta ketë pasur këtë varg. Ndaj këngëtarë virtuozë si Palokë Luketi, që e kishin dëgjuar të këndohej kështu dikur, ndonjëherë e shtonin vargun e suprimuar, si për të mos harruar evenimentin historik që e lindi këtë këngë.

Të gjitha vargjet e këngës *Fjalë-o për tel* kanë në vetvete detaje përcaktuese për origjinën e saj. Janë ato që e thonë qartë se kënga i përket vitit 1878 dhe se lënda artistike e saj është kushtrimi i dhënë në kohën kur, në Sarajet e Abdulla Pashë Drenit në Gjakovë, populli rrethoi Mehmet Ali Pashë Maxharrin. Lajmi i bujshëm për aksionin e Gjakovës ka të ngjarë t'i jetë dhënë *Degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit* në Shkodër me anë të *telegrafit*. Pastaj në Malësi është shpërndarë në formë *kushtrimi*.

Telegrafi në këtë këngë ka hyrë si një *mjet artistik* i modernizimit të kohës. Madje këtë *mjet* të ri artistik populli e përdor me shumë sukses. Ndoshta më me sukses se edhe vetë Fishta i cili këngën për "*Mehmet Ali Pashën*" e fillon në të njëjtën mënyrë me vargun: "*Po rreh tel i vilajetit*".²⁰⁾

Në vargjet tjera duket tepër qartë se fjalët që në mënyrë metaforike vijnë nepër tel ftojnë popullin të ngrihet në këmbë e të dalë në Gjakovë. Atje ku pashai turk kishte rënë në sherr, sepse kishte ardhur t'i bindi shqiptarët për të lëshuar tokat e të parëve, të cilat duhej t'i shkëputeshin Shqipërisë sipas vendimit të marrë në Berlin.

Kënga *Fjalë-o për tel* është kënga e fundit *majekrahi* e krijuar në Malësi. Me këtë këngë mbyllet epoka e krijimit të këngëve *majekrahi*. *Kushtrimet* mbi male vazhduan edhe për shumë kohë, por mekanizmi artistik i këthimit të tyre në këngë nuk funksionoi më.

Ndodh pra në çerekun e fundit të shekullit XIX që, thirrja njerzore në Shqipëri, vazhdon të bëhet pazazh muzikor. Është pikërisht ajo për të cilën Osvald Hanfling shkruan: "*Nuk ekzistojnë shumë pasazhe muzikore në të cilat do të ishte e besueshme gjetja e ngjashmërisë me thirrjen njerëzore...*"²¹⁾

²⁰⁾ At Gjergj Fishta: "*Lahuta e Malcisë*", 1937, faqe 110.

²¹⁾ Osvald Hanfling: "*Estetika Filozofike*", Shkodër 1999, fq.86.

Në mes të *Kangës-Majekrahit* dhe *kushtrimit*, përveç lidhjes së brendëshme, ekziston edhe një lidhje e jashtme. Kjo lidhje ka të bëjë me elementin *pushkë*. Qysh se ka hyrë në përdorim arma e zjarrit çdo kushtrim është shoqëruar me krisma pushke. Por edhe *Kanga-Majekrahit* shoqërohet me krisma pushke. Në *Këngën majekrahit*, pra, kuadri i *kushtrimit* është i plotë, ashtu siç është i plotë kuadri i *mejdanit* në *vallen e shpatave*.

Edhe shoqërimi, vetëm i *Këngës-Majekrahit*, gjithmonë me krisma pushke vërteton lindjen e saj nga *kushtrimi*. Asnjë këngë tjetër, madje as ajo me lahutë, nuk e gëzon këtë të drejtë që për malësorët është një e drejtë madhështore, por që në fakt është trashëgimi më domethënës nga origjina e saj e laegët.

Edhe në kohën tonë *Kanga-Majekrahit* vazhdon të këndohet në mënyrë autentike. Në Festalet Folklorike të Gjirokastrës janë dalluar për këtë këngë vëllezërit Buçi (Kola dhe Nushi) nga Bajza e Kastratit. Fatmirësisht kënga e tyre është e regjistruar. Ajo nuk ka se si të pësojë fatin tragjik të këngës së Pjetër Dules apo të Palokë Luketit, e cila konsiderohet e humbur plotësisht. Megjithatë në Malësi flitet se kënga e Pjetër Dules mund të gjendet në fonotekën e Radio Tiranës. Mbreti Zog në paradën e bërë me rastin e 25-vjetorit të Pamvarësisë ftoi edhe shumë burra të dëgjuar nga Malësia. Në mes tyre ishte edhe këngëtari Pjetër Dulja, sepse përveç dimensioneve të tjera ishte edhe oficer i Mbretërisë Thuhet se kënga e tij në këtë paradë është inçizuar. Madje ka një pohim se kjo këngë është dëgjuar në një emision të Radio Tiranës në vitin 1948. Sa për këngën e Palokë Luketit nuk kam ndonjë njoftim në se mund të ndodhet e regjistruar. Shpresa është se mos ekziston ndonjë inçizim privat, sepse një i internuar siç ishte ai, në vitet e regjimit totalitar, nuk mund të hynte në asnjë mënyrë në fondet e fonotekës së radjove që në këtë drejtim çensuroheshin me rreptësi. Mbase edhe kënga e Pjetër Dules për arsye të tilla, pas vitit 1948, nuk është transmetuar më dhe ka zënë pluhur në ndonjë cep të fonotekës apo është asgjësuar fare.

Të gjithë sa kanë folur për *Këngën-Majekrahit* e konsiderojnë atë një këngë *solo*. Është e vërtetë që ajo dendur këndohet *solo*, por është po kaq e vërtetë se ajo këndohet *solo* vetëm kur aty nuk janë dy këngëtarë që të jenë praktikuar të këndojnë *duet*. Zakonisht vargun e parë e këndon deri nga fundi, vetëm, këngëtari që fillon këngën, pastaj hyn këngëtari që e ndihmon. Nëqoftëse këngëtari i dytë heziton të hyjë në këngë, këngëtari i parë, pasi ka mbaruar vargun e parë, në çezurë, i thotë të dytit: "*Ma merr*". Pikërisht këtu, për mendimin tim, gjendet e përbashkëta shqiptare mes dy tipeve më të vjetra të këngës tonë të trashëguar, asaj *majekrahu* dhe këngës me *iso*. Për çudi studjuesit tanë nuk e kanë vënë re këtë të përbashkët, por i kanë rënë shkurt duke e futur këngën *majekrahu* në llojin e këngëve *solo*, ndërsa këngën me *iso* në grupin e këngëve polifonike. Por unë do të thosha se në analizë të fundit të dyja këto këngë në bazë kanë duetin. Këngën me *iso* gjithmonë e fillon një këngëtar dhe këngëtari tjetër ia këthen, krejtësisht në ngjashmëri me *Këngën-Majekrahit* Thelbi i këngës është ky, pamvarësisht se në këngën e Jugut hyn edhe elementi *iso* që i shton doza artistike, por vërehet lehtë se *isoja* është në sfond.

Ndërsa në *Këngën-Majekrahit* të dy këngëtarët që këndojnë duet këndojnë të njëjtën melodi dhe me të njëjtin tonalitet sa që të dy zërat të duket se shkrihen në një zë të vetëm, në këngën me *iso* nuk ndodh kështu. Po të vemë re me kujdes këngën e atij që ia merr dhe atij që ia pret do të

shohim se aty kemi jo një, por dy melodi. Ky për mendimin tim është ndryshimi esencial mes dy këngëve më të lashta që disponon folklori ynë muzikor.

Kanga-Majekrahit, jo rastësisht, është bërë, si të thuash, ADN-ja e malësorëve. Ajo ka sfiduar shekujt me optimizmin dhe besimin në fitoren përfundimtare. Bërja këngë e *kushtrimeve* nuk ka rreshtur, siç shihet qartë, sëpaku, në gjysmëmijëvjeçarin e pushtimit turk. Kjo do të thotë se populli në Malësi është ngritur gjithmonë vital mbi humbjet. *Kanga-Majekrahit*, kjo sentencë e moçme historike, e përsëritur gjithmonë e më me pathos, të duket sikur shpreh formulën e jetës luftarake të malësorëve. Të ngjan se në një dialog të përjetshëm me shekujt, njerzit në Malësi pyesin se deri kur do të vazhdojë që jeta e tyre të jetë një betejë e pafund. Dhe shekujt sikur përgjigjen: "Deri në vdekje". "Mirë - thonë malësorët - vazhdojmë".

2. PËRFUNDIME

1. *Kanga-Majekrahit* është një thesar i artit primitiv të stërgjyshërve tanë të lashtë. Ajo është pjellë e kohërave shumë të vjetra dhe pasqyron karakterin historik të shprehur në një ligjëratë tepër të thjeshtë, por tepër të thekëshme muzikore. Ky himn është modelimi më i moçëm artistik i kohrave të lashta historike që kaluan dikur në këto Male.
2. Jo rastësisht, kjo këngë e herëshme, është bërë, si të thuash, ADN-ja e malësorëve. Ajo ka sfiduar shekujt me optimizmin dhe besimin në fitoren përfundimtare. Bërja këngë e *kushtrimeve* nuk ka rreshtur, siç shihet qartë, sëpaku, në gjysmëmijëvjeçarin e pushtimit turk. Kjo do të thotë se populli në Malësi është ngritur gjithmonë vital mbi humbjet. *Kanga-Majekrahit*, kjo sentencë e moçme historike, e përsëritu
3. Përfundimisht, duke u mbështetur si në vetë brendinë e këngës si dhe në ato që këngëtarët e shquar të Malësisë, siç ishte Pjetër Dulja, i Kastratiti, i kanë transmetuar, nga brezi në brez, njëri-tjetrit për evenimentin historik që zakonisht e lind një *Kangë-Majekrahi*, mund të them, pa pasur dyshim se gaboj, që *Kanga-Majekrahu* që emërtohet *Fjalë po bjen era* është kushtrimi i dhënë mbi male, ndërsa në Kosovë vringëllonin shpatat më 1389.

3. STUDIME MBËSHTETËSE

- 1) *Eqrem Çabej*: "Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes", Tiranë, 1994, faqe 46.
- 2) *Ramadan Sokoli*: "Për traditat tona muzikore", Nëndori, nr.9 - 1965, faqe 117.
- 3) *Eqrem Çabej*: "Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes", Tiranë, 1994, faqe 46
- 4) *Edit Durham*: "Brenja e Ballkanit dhe vepra të tjera...", Tiranë 1990, faqe 128-129.
- 5) *Plehanov, Vorovski, Lunaçarski, Gorki*: "Estetika dhe letërsia", I, Tiranë 1974, faqe 51
- 6) *Eqrem Çabej*: "Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes", Tiranë 1994, faqe 47.

7) *Alfred Uçi*: "Estetika", Tiranë 1989, faqe 4.

8) *Ramadan Sokoli*: "Për traditat tona muzikore", Nëndori, Nr.9 - 1965, faqe 118.

9) *Selami Pulaha*: "Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shekujve XV-XVI", Tiranë 1984, faqe 17.

¹⁰⁾ *Marin Barleti*: "Rrethimi i Shkodrës", Tiranë 1982, faqe 55.

¹¹⁾ *Marin Barleti*: "Rrethimi i Shkodrës", Tiranë 1982, faqe 55.

12) *At Gjergj Fishta*: "Lahuta e Malcisë", 1937, faqe 110

¹³⁾ *Osvald Hanfling*: "Estetika Filozofike", Shkodër 1999, fq.86.

